



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2644/ 4 prot.

Datë 23.12.2022

V E N D I M
Nr. 1288/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.12.2022 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “AQUARIUS MEDICAL” SHPK në procedurën e “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*” me Nr. REF-48269-11-02-2022, me objekt “*Loti 1 Materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore (MM1)*”, me fond limit 1,466,734 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 14.11.2022 nga autoriteti kontraktor, Spitali Fier.

Autoriteti Kontraktor: Spitali Fier
Adresa: Lagjja “1 Maji” Rruga “Invalidët e Luftës”, Fier

Ankimues: Operatori ekonomik “AQUARIUS MEDICAL” SHPK
Adresa: Rruga “Don Bosko”, Blloku nr. 1, shkalla nr. 3, kati 1, nr. 4

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1 të nenit 30, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Rregullave të Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes:

II.1. Në datë 03.11.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-48269-11-02-2022, me objekt “Loti 1 Materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore (MM1)”, me fond limit 1,466,734 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 14.11.2022 nga autoriteti kontraktor, Spitali Fier.

II.2. Në datë 14.11.2022, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datë 22.11.2022 operatorët ekonomikë janë njohur me klasifikimin përfundimtar të ofertave si më poshtë:

- “AQUARIUS MEDICAL” SHPK	1,433,734.00	I skualifikuar
- “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK	2,040,700.00	I skualifikuar

II.4. Më datë 23.11.2022 autoriteti kontraktor publikoi në SPE njoftimin e anulimit të procedurës së prokurimit.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datë 25.11.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik është protokolluar ankesa me nr. 2644 prot., e operatorit ekonomik “AQUARIUS MEDICAL” SHPK me objekt shfuqizimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi me pretendimet se: Në lidhje me pikën e parë të skualifikimit të shoqërisë tonë nga kjo procedurë prokurimi, ku keni cituar: "Skualifikoheni për arsye se nuk keni përmbushur kriteret/ e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST për pasi në katalogun paraqitur për artikujt nr. 3 Bende elastike 7.5 cm x 4m/100% pambuk elastik, peshë 80-90Q/cm2 dhe nr. 20 Tub ushqimi pediatrik Ch 4, 5 Pediatrik, nëonatal. Pa latex/DEHP specifikimet teknike të këtyre dy zërave nuk janë të njëjte me kërkesat e përcaktuara në DST":

Për sa i përket kësaj pike të skualifikimit nga AK Spitali i Fierit, e kundërshtojmë pasi është në kundërshtim me Ligjin e prokurimit publik dhe rregullat e prokurimit publik, në lidhje me këto artikuj që keni përmendur, konkretisht artikulli nr. 3 dhe artikulli nr. 20, shoqëria jonë ka paraqitur dokumentacionin në SPE ku kemi deklaruar si kompani prodhuese e cila ka lëshuar autorizimin për pjesëmarrje për këto artikuj është Kompania prodhuese Ningbo Greetmed Medical Instruments me origjinë në Kinë, e cila ka caktuar si distributor zyrtar për Shqiperinë Kompaninë Evfarma, ku kjo e fundit si distributor zyrtar ka dhënë autorizimin për shoqërinë tonë për të marrë pjesë në këtë procedure prokurimi, ku ndër dokumentet e tjera që kemi paraqitur në SPE është edhe katalogu i artikujve i kompanisë prodhuese Ningbo Greetmed Medical Instruments, ku janë të pasqyruar të gjithë artikujt sipas specifikimeve teknike të parashikuara në DST. Në lidhje me artikullin nr. 3 Bende elastike 7.5 cm x 4m/100% pambuk elastik, peshë 8090g/cm2, sqarojmë se ky artikull është në katalogun e paraqitur nga ana jonë në SPE dhe konkretisht në file-n me emërtimin "19. GREETMED ALL", dhe konkretisht në faqen 58 me kodin GT089-100, por gabimisht (gabim njerëzor) nga ana jonë është markuar artikulli me kodin GT090-100, I cili është ngjitur në krah të majtë me këtë artikull. Fakti që nuk është markuar nga ana jonë nuk mund të konsiderohet nga ana e KVO-se si artikull që nuk përmbush specifikimet teknike dhe aq më tepër të përbeje shkak për skualifikim ky artikull është i paraqitur edhe i përshkruar në katalogun e paraqitur në SPE siç është kërkuar në DST, katalog i cili është i përkthyer dhe noterizuar.

Për sa i përket pikës tjetër të skualifikimit në lidhje me artikullin nr. 20 Tub ushqimi pediatrik Ch 4, 5 Pediatrik, neonatal. Pa latex/DEHP, ku keni cituar që specifikimet teknike të këtij zëri nuk janë të njëjta me kërkesat e përcaktuara në DST";, ju sqarojmë se si është e mundur që keni përmendur si arsye skualifikimi pasi ky artikull është paraqitur nga ana jonë në sistemin e prokurimit elektronike dhe konkretisht në file-n me emërtimin "19. GREETMED ALL", në faqen 51 me kodin GTOI 8-100, i cili është markuar nga ana jonë dhe i përkthyer dhe noterizuar (faqe 67 të po këtij file) sic kërkohet në DST, në katalogun e paraqitur për këtë artikull (faqen 51 në gjuhën angleze dhe faqe 67 i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe) është i njëjtë sipas specifikimeve teknike të parashikuara në DST.

2. Në lidhje me pikën e dytë të skualifikimit të shoqërisë tonë nga kjo procedurë prokurimi ku keni cituar: Autorizimi i lëshuar nga kompania prodhuese/ distributor i autorizuar lidhur me strehimin e artikujve të ofertuar dhe konkretisht për artikullin nr. 2 Alkol/ 90-96% është i pavlefshëm për arsye se autorizimi i paraqitur nga OE “Aquarius Medical” shpk Tiranë

lëshuar nga Aqua Medical është pa datë gjë e cila nuk e identifikon datën e lëshimit të dokumentit të lëshuar në rastin aktual të autorizimit të prodhuesit.

Për sa i përket kësaj pike të skualifikimit nga AK Spitali i Fierit, e kundërshtojmë pasi është në kundërshtim me Ligjin e prokurimit publik dhe rregullat e prokurimit publik, në lidhje me këto artikuj që keni përmendur, konkretisht artikulli nr. 21 Alkool/90-96% shoqëria jonë ka paraqitur dokumentacionin në SPE ku kemi deklaruar si kompani prodhuese e cila ka lëshuar autorizimin për pjesëmarrje për këtë artikull është Kompania prodhuese Aqua Medical me origjinë në Turqi, e cila ka caktuar si distributor zyrtar për Shqipërinë Kompaninë tonë për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi dhe në të gjithë procedurat e tjera zhvilluara në territorin e Republikës së Shqipërisë nga autoritete private dhe shtetërore, ku ndër dokumentet e tjera të lëshuara nga kompania prodhuese që kemi paraqitur në këtë procedurë prokurimi është edhe dokumenti i Autorizimit të Prodhuesit lëshuar për kompaninë tonë, ku ndër te tjera ky dokument citon që: "Autorizon Shoqërinë tonë për të ofruar, negociuar dhe konkluduar në territorin e Shqipërisë Aquarius Medical Shpk dhe të gjitha kompanite e tjera të autorizuar prej nesh, publike dhe Private, për çdo mall të prodhuar nga ne dhe çdo mall tjetër të prodhuar nga degët e kompanisë sonë. Ne japim garancinë dhe sigurinë tonë të plotë për mallrat e ofruara për furnizim nga kompania jonë dhe degët e kompanisë. Ky vërtetim është i vlefshëm pa afat.

3. Gjithashtu kundërshtojmë dhe arsyen tjetër të skualifikimit të ofertës tonë në lidhje me: "Autorizimi i lëshuar nga Distributori i Autorizuar lidhur me tregtimin e artikujve të ofruar dhe konkretisht për artikullin nr. 13 Letër Drinteri ECHO 6-12 kanale është i pavlefshëm për arsye se autorizimi i paraqitur nga OE Aquarius Medical" ShPK Tiranë lëshuar nga distributori i autorizuar Ardian Teferiçi është pa data (pa datë fillimi dhe mbarimi) gjë e cila nuk e përcakton kohën e vlefshmërisë të dokumentit të lëshuar në rastin aktual të autorizimit të distributorit të autorizuar. Gjithashtu në katalogun e paraqitur letër printeri nuk i përmbush kriteret e përcaktuara në DST, Certifikata CE 1976/MDD "Certifikata e Miratimit të Sistemit të Sigurimit të Cilësisë së Prodhimit" e prodhuesit Cecarta spa skadon me datë 17.11.2022 pra nuk garanton që produkti i ofruar do të jetë në përputhje me CE pse CE sipas direktivës (MDD ose MDR) 93/42 EEC'. Në lidhje me këtë arsye skualifikimi sqarojmë se kundërshtojmë argumentin e dhënë nga ana e AK pasi bie ndesh me legjislacionin e prokurimit publik dhe kriteret e parashikuara në dokumentet e tenderit për kualifikim pasi për artikullin nr. 13 Letër printeri ECHO 6-12 kanale, kemi paraqitur dokumentacionin në SPE ku kemi deklaruar si kompani prodhuese e cila ka lëshuar autorizimin për pjesëmarrje për këtë artikull është Kompania prodhuese Ceracarta me origjinë në Itali, e cila ka caktuar si distributor zyrtar për Shqipërinë shoqërinë "Ardian Teferiçi", ku ky i fundit ka lëshuar autorizimin për kompaninë tonë për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi dhe në të gjithë procedurat e tjera zhvilluara në territorin e Republikës së Shqipërisë ku ndër dokumentet e tjera të lëshuara nga kompania prodhuese që kemi paraqitur në këtë procedurë prokurimi është edhe dokumenti i Autorizimit të Prodhuesit.

Në lidhje me pikën tjetër të skualifikimit, nuk arrijmë të kuptojmë se si është e mundur që keni cituar si arsye skualifikimi faktin që kjo certifikatë skadon me datë 17.11.2022 ku ndërkohë që data e zhvillimit të procedurës nga ana juaj është data 14.11.2022.

II.6. Bazuar në nenin 112, pika 3 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin,

adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, nr. Reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si edhe formularin e publikimit me nr. 2644/2 prot., datë 25.11.2022, duke publikuar arsyet e skualifikimit të tij, në procedurën e prokurimit.

II.7. Me shkresën nr. 6214/2 prot., datë 05.12.2022, protokolluar me tonën me nr. 2644/3, datë 09.12.2022, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik Vendimin e KSHA-së për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “AQUARIUS MEDICAL” SHPK.

II.8. Referuar shkresës së mësipërme të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues duke mos e pranuar atë.

II.9 Me aktin me nr.6214, datë 05.12.2022, Komisioni i Shqyrtimit të ankesave pranë autoritetit kontraktor ka argumentuar: *Me gjithë pretendimet e ngritura nga ana e operatorit ekonomik: “AQUARIUS MEDICAL” SHPK Tiranë ankesa nuk merret parasysh pasi po të kalohej në rivlerësim përsëri përfundimi i vlerësimit do të ishte i njëjtë skualifikim për mospërbushje të kriterëve të përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit. Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “AQUARIUS MEDICAL” SHPK Tiranë nuk është i bazuar në ligj dhe si i tillë nuk merret parasysh.*

II.10. Referuar nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, nuk është paraqitur asnjë argument nga operatorë ekonomikë të interesuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “AQUARIUS MEDICAL” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: *Në lidhje me pikën e parë të skualifikimit të shoqërisë tonë nga kjo procedurë prokurimi, ku keni cituar: “Skualifikoheni për arsye se nuk keni përmbushur kriteret/ e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST për pasi në katalogun paraqitur për artikujt nr. 3 Bende elastike 7.5 cm x 4m/100% pambuk elastik, pesha 80-900/cm2 dhe nr. 20 Tub ushqimi pediatrik Ch 4, 5 Pediatrik, nëonatal. Pa latex/DEHP specifikimet teknike të këtyre dy zërave nuk janë të njëjte me kërkesat e përcaktuara në DST”:*

Për sa i përket kësaj pike të skualifikimit nga AK Spitali i Fierit, e kundërshtojmë pasi është në kundërshtim me Ligjin e prokurimit publik dhe rregullat e prokurimit publik, në lidhje me këto artikuj që keni përmendur, konkretisht artikulli nr. 3 dhe artikulli nr. 20, shoqëria

jonë ka paraqitur dokumentacionin në SPE ku kemi deklaruar si kompani prodhuese e cila ka lëshuar autorizimin për pjesëmarrje për këto artikuj është Kompania prodhuese Ningbo Greetmed Medical Instruments me origjinë në Kinë, e cila ka caktuar si distributor zyrtar për Shqipërinë Kompaninë Evfarma, ku kjo e fundit si distributor zyrtar ka dhënë autorizimin për shoqërinë tonë për të marrë pjesë në këtë procedure prokurimi, ku ndër dokumentet e tjera që kemi paraqitur në SPE është edhe katalogu i artikujve i kompanisë prodhuese Ningbo Greetmed Medical

Instruments, ku janë të pasqyruar të gjithë artikujt sipas specifikimeve teknike të parashikuara në DST. Në lidhje me artikullin nr. 3 Bende elastike 7.5 cm x 4m/100% pambuk elastik, pesha 80-90g/cm², sqarojmë se ky artikull është në katalogun e paraqitur nga ana jonë në SPE dhe konkretisht në file-n me emërtimin "19. GREETMED ALL", dhe konkretisht në faqen 58 me kodin GT089-100, por gabimisht (gabim njerëzor) nga ana jonë është markuar artikulli me kodin GT090-100, i cili është ngjitur në krah të majtë me këtë artikull. Fakti që nuk është markuar nga ana jonë nuk mund të konsiderohet nga ana e KVO-se si artikull që nuk përmbush specifikimet teknike dhe aq më tepër të përbeje shkak për skualifikim ky artikull është i paraqitur edhe i përshkruar në katalogun e paraqitur në SPE sic është kërkuar në DST, katalog i cili është i përkthyer dhe noterizuar.

Për sa i përket pikes tjetër të skualifikimit në lidhje me artikullin nr. 20 Tub ushqimi pediatrik Ch 4, 5 Pediatrik, neonatal. Pa latex/DEHP, ku keni cituar që specifikimet teknike i këtij zëri nuk janë të njëjtë me kërkesat e percaktuara në DST"; ju sqarojmë se si është e mundur që keni përmendur si arsye skualifikimi pasi ky artikull është paraqitur nga ana jonë në sistemin e prokurimit elektronike dhe konkretisht në file-n me emërtimin "19. GREETMED ALL", në faqen 51 me kodin GTOI 8-100, i cili është markuar nga ana jonë dhe i përkthyer dhe noterizuar (faqe 67 të po këtij file) sic kërkohet në DST, në katalogun e paraqitur për këtë artikull (faqen 51 në gjuhën angleze dhe faqe 67 i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe) është i njëjtë sipas specifikimeve teknike të parashikuara në DST

III.1.1. Në shtojcën 8 "Formular i specifikimeve teknike", Lot. 1 - Materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore të dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Nr.	Artikulli	Specifikime	Njesia
1	Sisteme infuzioni	Sistem infuzioni transparente dhe fleksibel e pershtatshme si për shishet edhe për qeset e infuzionit, e pajisur me valvol ajrimi + filter + age, luer lock + bashkuese e gomuar në formë "Y" ose "flashball", me PP flow rregullator, 20 pika / 1ml, e paketuar me qese të sterilizuara.	Copë
2	Bende 20 cm x 10 m	100% pambuk absorbent, dendësia 24x20	Copë
3	Bende elastike 7.5cm x 4m	100% pambuk elastik, pesha 80-90g/cm ²	Copë
4	Bende allcie 10cm x 2.7m	Paketimi individual plastik	Copë
5	Doreza ekzaminimi (ndare sipas numrit)	Josterile, me latex natyral, me puder, me permasa XS, S, M, L.	Copë

6	Dren silikoni	Ch 16-28, L=50cm, me vrima a neseore i detektueshem nga rrezet X	Copë
7	Elektroda monitorimi EKG	Elektroda monitorimi njeperdorimeshe	Copë
8	Garze 91 cm x 100 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	m. linear
9	Kateter aspirimi adult	Ch 12, 14, 16, 18.	Copë
10	Komprese sterile 10cm x 10cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 16pala; paketim individual (1 cope/pako)	Copë
11	Lama bisturie	Nr: 15, 20, 21, 22, 23, 24	Copë
12	Leukoplast 5cm x 5m	cope 100% pambuk, ngjites me permbajtje oksid zingu	Copë
13	Leter printeri ECHO 6-12 kanale		Copë
14	Maske oksigjeni	me zgjatues L=1.5-2m	Copë
15	Pambuk kirurgjikal	100% pambuk hidrofil, pakete 100g	Copë
16	Qarqe respiratori	per respirim artificial L= 1.5 m; ID 22 mm	Copë
17	Sonde oksigjeni adult	nazale, adult, L=1.5-2 m	Copë
18	Set drenimi Redon me vakum ne forme fizarmonike 500-800ml Komplet redoni G 12-22	Set=(ballon vakumi+form z fold tub+dren+troakar)	set
19	Termometer	termometer pacienti	Copë
20	Tub ushqimi pediatrik	Ch 4, 5. Pediatrik, neonatal. Pa latex/DEHP.	Copë
21	Alkol	90-96%	litra

III.1.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “AQUARIUS MEDICAL”SHPK, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

- Katalogu të artikujve të kompanisë prodhuese Ningbo Greetmed Medical Instruments.

III.1.3. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.1.4. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: *“1.Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të*

lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret.

III.1.5 Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

II.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim si dhe specifikimeve teknike ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim si dhe specifikimet teknike, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor dhe specifikimet teknike, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.6. Në rastin konkret, nga verifikimi në SPE vihet re, se në përmbushje të specifikimit më sipër operatori ekonomik ka dorëzuar Katalogu të artikujve të kompanisë prodhuese Ningbo Greetmed Medical Instruments i cili është i përkthyer dhe noterizuar.

Nga verifikimi i katalogut të paraqitur nga operatori ekonomik “AQUARIUS MEDICAL” SHPK, KPP vëren se në kodin GT089-100 është përcaktuar artikulli me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet standarde të procedurës së prokurimit, për artikullin nr. 3 *Bende elastike 7.5 cm x 4m/100% pambuk elastik, peshë 80- 90g/cm² dhe në kodin GT018-10* është përcaktuar artikulli me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet standarde të procedurës së prokurimit, për artikullin nr. 20 *Tub ushqimor*. Në përgjigjen e kthyer nga autoriteti kontraktor Spitali Fier me nr. 6214 prot., datë 05.12.2022, autoriteti kontraktor ka dështuar në argumentimin e arsyes së mospranimit të ankesës duke mos dhënë argumente justifikuese dhe konkrete se përse këto artikuj nuk plotësojnë elementet e përcaktuara në specifikimet teknike. Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që operatori ekonomik të ofertojë produkte të cilat janë komform specifikimeve teknike dhe plotësojnë termat funksionalë, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. Fakti i pretenduar nga autoriteti kontraktor se operatori ekonomik nuk e ka markuar artikullin nr. 3 *Bende elastike 7.5 cm x 4m/100% pambuk elastik, peshë 80- 90g/cm por e ka të përfshirë në katalogun të artikujve të kompanisë prodhuese Ningbo Greetmed Medical Instruments, vlerësohet i provuar se operatori*

ekonomik ankimues e ofron këtë artikull, fakt i cili është i rëndësishëm për realizimin me sukses të kontaktës.

Për sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “AQUARIUS MEDICAL” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: *Në lidhje me pikën e dytë të skualifikimit të shoqërisë tonë nga kjo procedurë prokurimi ku keni cituar: Autorizimi i lëshuar nga kompania prodhuese/distributor i autorizuar lidhur me strehtimin e artikujve të ofertuar dhe konkretisht për artikullin nr. 2 Alkol/ 90-96% është i pavlefshëm për arsye se autorizimi i paraqitur nga OE “Aquarius Medical” ShPK Tiranë lëshuar nga Aqua Medical është pa datë gjë e cila nuk e identifikon datën e lëshimit të dokumentit të lëshuar në rastin aktual të autorizimit të prodhuesit. Gjithashtu kundërshtojmë dhe arsyen tjetër të skualifikimit të ofertës tonë në lidhje me: “Autorizimi i lëshuar nga Distributori i Autorizuar lidhur me tregtimin e artikujve të ofruar dhe konkretisht për artikullin nr. 13 Letër Drinteri ECHO 6-12 kanale është i pavlefshëm për arsye se autorizimi i paraqitur nga OE Aquarius Medical” ShPK Tiranë lëshuar nga distributori i autorizuar Ardian Teferici është pa data (pa datë fillimi dhe mbarimi) gjë e cila nuk e përcakton kohën e vlefshmërisë të dokumentit të lëshuar në rastin aktual të autorizimit të distributorit të autorizuar.*

Për sa i përket kësaj pike të skualifikimit nga AK Spitali i Fierit, e kundërshtojmë pasi është në kundërshtim me Ligjin e prokurimit publik dhe rregullat e prokurimit publik, në lidhje me këto artikuj që keni përmendur, konkretisht artikulli nr. 21 Alkool/90-96% shoqëria jonë ka paraqitur dokumentacionin në SPE ku kemi deklaruar si kompani prodhuese e cila ka lëshuar autorizimin për pjesëmarrje për këtë artikull është Kompania prodhuese Aqua Medical me origjinë në Turqi, e cila ka caktuar si distributor zyrtar për Shqipërinë Kompaninë tonë për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi dhe në të gjithë procedurat e tjera zhvilluara në territorin e Republikës së Shqipërisë nga autoritete private dhe shtetërore, ku ndër dokumentet e tjera të lëshuara nga kompania prodhuese që kemi paraqitur në këtë procedurë prokurimi është edhe dokumenti i Autorizimit të Prodhuesit lëshuar për kompaninë tonë, ku ndër te tjera ky dokument citon që: "Autorizon Shoqërinë tonë për të ofruar, negociuar dhe konkluduar në territorin e Shqipërisë Aquarius Medical ShPK dhe të gjitha kompanitë e tjera të autorizuar prej nesh, publike dhe Private, për çdo mall të prodhuar nga ne dhe çdo mall tjetër të prodhuar nga degët e kompanisë sonë. Ne japim garancinë dhe sigurinë tonë të plotë për mallrat e ofruara për furnizim nga kompania jonë dhe degët e kompanisë. Ky vërtetim është i vlefshëm pa afat. Në lidhje me këtë arsye skualifikimi sqarojmë se kundërshtojmë argumentin e dhënë nga ana e AK pasi bie ndesh me legjislacionin e prokurimit publik dhe kritereve të parashikuara në dokumentet e tenderit për kualifikim pasi për artikullin nr. 13 Letër printeri ECHO 6-12 kanale, kemi paraqitur dokumentacionin në SPE ku kemi deklaruar si kompani prodhuese e cila ka lëshuar autorizimin për pjesëmarrje për këtë artikull është Kompania prodhuese Ceracarta me origjinë në Itali, e cila ka caktuar si distributor zyrtar për Shqipërinë shoqërinë "Ardian Teferici", ku ky i fundit ka lëshuar autorizimin për kompaninë tonë për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi dhe në të gjithë procedurat e tjera zhvilluara në territorin e Republikës së Shqipërisë ku ndër dokumentet e tjera të lëshuara nga kompania prodhuese që kemi paraqitur në këtë procedurë prokurimi është edhe dokumenti i Autorizimit të Prodhuesit.

III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, nëntitulli 2.3 “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.5 të dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Kriteri 2.3.5: *Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese/distributor i autorizuar lidhur me tregtimin e artikujve të ofruar. Në rastin e distributorit të autorizuar të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës.*

III.2.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “AQUARIUS MEDICAL” SHPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

- *Autorizim të Prodhuesit nga kompania prodhuese “Aqua Medical” që autorizon shoqërinë “AQUARIUS MEDICAL” SHPK si distributor në Republikën e Shqipërisë.*
- *Autorizim të distributorit të autorizuar “Ardian Teferici” që autorizon shoqërinë “AQUARIUS MEDICAL” SHPK për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit në Republikën e Shqipërisë.*

III.2.3 Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.2.4. Në nenin 41 pika 4 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

ç) *mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

d) *Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.*

III.2.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale,

kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Referuar kriterit se *Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese/distributor i autorizuar lidhur me tregtimin e artikujve të ofruar. Në rastin e distributorit të autorizuar të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës* operatori ekonomik ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik *Autorizim të Prodhuesit nga kompania prodhuese "Aqua Medical" që autorizon shoqërinë "AQUARIUS MEDICAL" SHPK si distributor në Republikën e Shqipërisë për artikullin nr. 2 Alkool/ 90-96% dhe Autorizim të distributorit të autorizuar "Ardian Teferici" që autorizon shoqërinë "AQUARIUS MEDICAL" SHPK për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit në Republikën e Shqipërisë për artikullin nr. 13 Letër Printeri ECHO 6-12 kanale.* Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se për autoritetin kontraktor vendosja e kërkesave të veçanta për kualifikim ka si synim rritjen e besueshmërisë së autoritetit kontraktor se operatorët ekonomikë ofertues nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme. *Nëpërmjet Autorizim të Prodhuesit nga kompania prodhuese "Aqua Medical" që autorizon shoqërinë "AQUARIUS MEDICAL" SHPK si distributor në Republikën e Shqipërisë, autorizohet shoqëria "AQUARIUS MEDICAL" SHPK për të ofruar, negociuar dhe konkluduar në territorin e Shqipërisë Aquarius Medical ShPK dhe të gjitha kompanitë e tjera të autorizuar prej nesh, publike dhe Private, për çdo mall të prodhuar nga ne dhe çdo mall tjetër të prodhuar nga degët e kompanisë sonë. Ne japim garancinë dhe sigurinë tonë të plote për mallrat e ofruara për furnizim nga kompania jonë dhe degët e kompanisë. **Ky vërtetim është i vlefshëm pa afat.*** Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se në këtë autorizim përcaktohet në mënyrë eksplicite vlefshmëria e autorizimit pa afate, e cila është e shtrirë në kohë dhe e vlefshme në momentin e zhvillimit të procedurës dhe pasqyron thelbin dhe qëllimin për të cilin është lëshuar. Fakti që ky autorizim nuk ka një datë për lëshimin e tij nuk i cenon kushtet e vlefshmërisë së tij dhe nuk e bën atë të pavlefshëm si akt. Komisioni vlerëson se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet disponueshmëria e këtij akti me qëllim plotësimin e kriterëve për kualifikim dhe realizimin me sukses të kontratës.

Në lidhje me artikullin nr. 13 Letër Printeri ECHO 6-12 kanale, operatori ekonomik ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik *Autorizim të distributorit të autorizuar "Ardian Teferici" që autorizon shoqërinë "AQUARIUS MEDICAL" SHPK për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit në Republikën e Shqipërisë. Në këtë autorizim përcaktohet qartësisht se autorizohet "AQUARIUS MEDICAL" SHPK të paraqesë oferta në procedure e prokurimit publik të organizuara nga të gjithë institucionet shtetërore në Republikën e Shqipërisë dhe për rrjedhojë i nënshkruaj kontratë furnizimi.* Sikurse u argumentua më lart Komisioni vlerëson, se për sa kohë ky autorizim plotëson qëllimin dhe thelbin për të cilin është lëshuar, përcaktimi i datës së lëshimit të tij nuk cenon vlefshmërinë e aktit. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se në rastet kur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka paqartësi apo dyshime

ka të drejtën të kërkojë sqarimi dhe të kryejë verifikime siç përcaktohet qartë dhe tek kriteret e veçanta të kualifikimit (Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesi).

Për sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “*AQUARIUS MEDICAL*” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: *Në lidhje me pikën tjetër të skualifikimit “Gjithashtu në katalogun e paraqitur letër printeri nuk i përmbush kriteret e përcaktuara në DST, certifikata CE 1976/MDD “Certifikatë e Miratimit të Sistemit të Cilësisë së Prodhimit” e prodhuesit Cecarta spa skadon me datë 17.11.2022 pra nuk garanton që produkti i ofruar do të jetë në përputhje me CE pse CE sipas direktivës (MDD ose MDR) 93/42 EEC”, nuk arrijmë të kuptojmë se si është e mundur që keni cituar si arsye skualifikimi faktin që kjo certifikatë skadon me datë 17.11.2022 ku ndërkohë që data e zhvillimi të procedurës nga ana juaj është data 14.11.2022.*

III.3.1. Në shtojcën 7 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, nëntitulli 2.3 “*Kapaciteti teknik*”, pika 2.3.4 të dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Kriteri 2.3.5: *Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose CE sipas direktivës (MDD ose MDR) 93/42 EEC, të vlefshme, ose certifikata FDA, ose ekuivalente, për artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre.*

III.3.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “*AQUARIUS MEDICAL*” SHPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

- *Certifikata CE 1976/MDD “Certifikatë e Miratimit të Sistemit të Cilësisë së Prodhimit” e prodhuesit Cecarta spa*

III.3.3 Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.3.4. Në nenin 41 pika 4 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.3.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Referuar kriterit se *Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata komformiteti CE ose CE sipas direktivës (MDD ose MDR) 93/42 EEC, të vlefshme, ose certifikata FDA, ose ekuivalente, për artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre operatori ekonomik ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik Certifikata CE 1976/MDD “Certifikatë e Miratimit të Sistemit të Cilësisë së Prodhimit” e prodhuesit Cecarta spa për artikullin nr. 13 Letër Printeri ECHO 6-12 kanale. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se për autoritetin kontraktor vendosja e kërkesave të veçanta për kualifikim ka si synim rritjen e besueshmërisë së autoritetit kontraktor se operatorët ekonomikë ofertues nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme. Nëpërmjet Certifikata CE 1976/MDD Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se afati i vlefshmërisë së saj është deri me datë 17.11.2022. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik konstatohet se data e zhvillimit të procedurës është data 14.11.2022. Rezulton e provuar se Certifikata CE 1976/MDD në momentin e zhvillimit të procedurës është brenda afatit të vlefshmërisë. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se për sa kohë Certifikata CE 1976/MDD është brenda periudhës së vlefshmërisë në momentin e zhvillimit të procedurës, nuk mund të jetë arsye për skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues.*

Për sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.

766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “AQUARIUS MEDICAL”SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-48269-11-02-2022, me objekt “Loti 1 Materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore (MMI)”, me fond limit 1,466,734 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 14.11.2022 nga autoriteti kontraktor, Spitali Fier.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “AQUARIUS MEDICAL”SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “AQUARIUS MEDICAL”SHPK.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri